

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË /DIVIZ.KUNDËRVAJTJËS/, me Gjyqtarin Nehat Qelaj dhe sek.juridike Nexhmije Dakaj në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Reshit Ahmet Krasniqi nga Malisheva, për shkak të kundërvajtjes nga neni 7 paragrafi i ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, si dhe në bazë të nenit 73, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet (LMK) me dt.16.12.2013, mori këtë:

A K T V E N D I M

Dep.	DPK/DMP	Nr Prot	
Dep.		Br Prot	03-4547/13
Nr. i faq.		Prot No	
Broj stranica	03	Data	
Nr. pages		Datum	31.12.2013
		Date	

I pandehuri: Reshit Kryeziu nga i ati Ahmet i lindur me datën 19.10.1961 në fshatin Savrov K.Suharekës, ndërsa tani me banim në rrugën „Hamdi Berisha“ lagjeja e Mirditës në Malishevë, i martuar i ati i dy (2) fëmijëve, zyrtar Kryesor Financiar në Komunën e Malishevës, ka të kryer fakultetin Ekonomik-master, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R.Kosovës,

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S :

Sepse në afatin prej 01 deri 31 Mars 2012 si zyrtar Kryesor Financiar në Komunën e Malishevës nuk e deklaroi pasurinë e tij me ç'rast nuk e përmbush obligimin ligjor që parahihet me nenin 5 dhe 6 paragrafi 1.1 të ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

-me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni nga neni 7 të ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

- prandaj në bazë të këtyre dispozitave dhe në kuptim të nenit 17 paragrafi 1.2 të të njëjtit ligj si dhe konform nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i njëjti :

D Ë N O H E T

Me gjobë në shumën prej katërqindpesdhjet euro (450 €)

Obligohet i pandehuri që gjobën e shqiptuar të paguan në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi në xhironlogari të Këshillit Gjyqësor No.1000 4300 7000 0518, në të kundërtën e njëjta do të zëvendësohet me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetegjashtë (36) ditësh duke llogaritur 15 euro për një ditë burg, po ashtu i pandehuri obligohet që në afat të lartcekur të paguaj 10 € në emër të paushallit gjyqësor, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohet parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri.

A R S Y E T I M

Agjensioni Kundër Korrupsionit parashtrroi kërkesën nr.01-4278/2012 të datës 26.11.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Reshit Ahmet Krasniqi nga Malisheva, për shkak të kundërvajtjes nga neni 7 paragrafi i ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Për shqyrtimin e kësaj qështje gjyqtari i qështjes caktoi senac dhe ftoi të pandehurin që me datën 23.04.2013 të paraqitet në gjykatë që të deklarohet në mbrojtjen e tij për kundërvajtjen me të cilën ngarkohet.

Në gjykatë sipas ftesës së kësaj gjykate është paraqitë I pandehuri dhe në seancës e datës 23.04.2013 pasi që i'u komunikua kërkesa për hapjen e procedurës kundërvajtëse ndaj tij dhe kundërvajtjen me të cilën ai ngarkohet i njëjti për këtë qështje deklaroi se:

